

Raport Vjetor



Kolegji FAMA
Gustav Majer 7 ,10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 - (0)38 - 222 212
E-mail: info@kolegijfama.eu



Instituti për zhvillim dhe Bashkëpunim
Ekonomik Ndërkombëtar **IZHBEN-FAMA**

Trendet e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë

Prishtinë,
Dhjetor 2014

Hulumtimi u realizua nga

ekipi hulumtues:

Bekim Marmullaku

Durim Hoxha

Mic Ukaj

Anketimi në terren u realizua nga grupet e studentëve të Kolegjit FAMA

*Hulumtimi u përkrah dhe u financua nga **Kolegji FAMA dhe IZHBEN-FAMA***

Falënderime

Ky raport është shkruar nga ekipi i hulumtimit dhe kolegëve tjerë në Institutin për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar IZHBEN – FAMA.

Kontribut shtesë kanë dhënë edhe studentët e Kolegjit Fama nga qendrat e saj në Prishtinë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë si dhe profesorë të këtij kolegj.

IZHBEN – FAMA dëshiron që posaçërisht të falënderojë Kolegjin Fama për përkrahjen dhe financimin e këtij hulumtimi. Gjithashtu, falënderojmë komunitetin e biznesit, të cilët gjatë anketimit u pajtuan që të ndajnë perceptimet e tyre me ne.

Ekipi hulumtues
Dhjetor, 2014

Shkurtesat

ABRK Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve ne Kosovë

MTI Ministrisa e Tregtisë dhe Industrisë

IZHBEN Instituti për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar

NVM Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

Përmbajtja:

1. Hyrja
2. Metodologjia e Hulumtimit
3. Pasqyrë e përgjithshme mbi NVM-të në Kosovë.
4. Hyrjet dhe daljet nga tregu
5. Rezultatet e Hulumtimit
6. Konkluzionet dhe Rekomandimet

1. Hyrje

Sektori privat në Republikën e Kosovës konsiston kryesisht në ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Ato gjenerojnë numrin më të madh të vendeve të reja të punës dhe paraqesin shtyllën kurizore të ekonomisë vendore. Në shumicën e vendeve në tranzicion ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë bartur barrën më të madhe të transformimit drejt ekonomisë së lirë të tregut. NVM-të jo vetëm që kanë krijuar vende të reja të punës, por edhe kanë absorbuar fuqinë punëtore që ka mbetur pa punë gjatë transformimit të pronës shoqërore/publike në atë private.

Duke qenë të rëndësishme për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe shoqëror, NVM-të kanë qenë objekt studimi i shumë shkenctarëve dhe hulumtuesve e poashtu edhe institucioneve shtetërore dhe joshtetërore. Fatmirësisht edhe në Kosovë hulumtimet lidhur me NVM-të datojnë qysh para vitit 1999. Këto hulumtime kryesisht bazohen në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në afarizmin e NVM-ve, trendet zhvillimore, barrierat e ndryshme institucionale dhe jo institucionale, si dhe çështje të ndryshme të rëndësishme për NVM-të.

Ky raport është, publikimi i parë i Kolegjit FAMA, lidhur me zhvillimin e NVM-në Kosovë, dhe shënon bashkëpunimin gjithëpërfshirës në mes studentëve, NVM-ve dhe profesorëve të Kolegjit FAMA. Për më tepër në planet zhvillimore të Kolegjit FAMA synohet që ky hulumtim të ndërmirret gjatë cdo viti. Kjo do të mundësonte analizën më të thukët të rezultateve sidomos në aspekt krahasimtar.

Më herët FAMA ka publikuar raporte dhe studime lidhur me zhvillimet në tregun e punës.

Ky hulumtim bazohet kryesisht në anketën e realizuar me qytetarë të Kosovës të grupmoshave 18-35 vjeç dhe në një anketë me bizneset kosovare, të nxjerra nga një mostër joproporcionale nëpër ndërmarrje të madhësive të ndryshme që operojnë në Kosovë. Bazohet në të dhënat sasiore dhe cilësore të dala nga pyetësorët e plotësuar nga të dy grupet e lartpërmendura për anketim. Të dhënat sekondare janë marrë nga institucionet publike, siç janë Zyrat për Punësim në nivel komunal dhe regjional, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe nga Enti i Statistikave.

Merren parasysh karakteristika të ndryshme, siç janë të rinjtë e një moshe të brezit 18- 35 vjeç, niveli i tyre i shkollimit, profesioni, bizneset e ndryshme që dallohen si nga veprimtaria e tyre afariste, ashtu edhe për nga madhësia e ndërmarrjes.

Raporti përqendrohet kryesisht në identifikimin e karakteristikave të të rinjve të papunë, shkallën e tyre të papunësisë dhe arsyet e një gjendjeje të tillë. Identifikon nivelin e arsimimit të të rinjtë, sidomos të të papunësuarit dhe profesionet e tyre në nivele të ndryshme të arsimimit.

Raporti, gjithashtu fokusohet në kërkesat specifike të ndërmarrjeve në Kosovë për burime njerëzore dhe identifikon nevojat për profesione dhe profile të kërkuara nga bizneset kosovare. Vërehet se përqindja më e ulët e të papunësuarve gjendet te të rinjtë me përgatitje profesionale. Kjo na jep idenë se ndërmarrjet ose institucionet e ndryshme preferojnë përgatitjet profesionale më shumë sesa një nivel të lartë të arsimimit nga punëkërkesit.

2. Metodologjia e Hulumtimit

Hulumtimi me Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme është kryer në bashkëpunim në mes të ligjeruesve dhe studentëve të Kolegjit FAMA. Në fakt ka qenë iniciativë e ligjeruesve të Departamentit të Menaxhmentit të Fakultetit Ekonomik, që të ndërmarrin një iniciativë të përbashkët me studentët e Kolegjit, që bashkarisht të trajtohet një temë e rëndësishme specifike, për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Nëpërmes këtij hulumtimi është synuar që studentët t'i mësojnë teknikat e intervistimit, dhe të familjarizohen me punën në teren. Në këtë mënyrë studentët do të përgaditen për hulumtimet e rradhës gjatë studimeve të tyre, sidomos për punimin e diplomës dhe studimet master. Për më tepër me këtë hulumtim është synuar që studentët të njihen nga dora e parë më trendet e zhvillimit të një ndërmarrje, motivet e ndarmarrësve, problemet me të cilat ballafaqohen NVM-të në Kosovë dhe synimet për të ardhmen. Së bashku me aspektet teorike të spjeguar gjatë ligjeratave, hulumtimi do të përmbushte edhe aspektin praktik dhe hulumtues të mësimdhënies që padyshim është pjesë e rëndësishme e mesimnxënies. Paraprakisht, studentët janë njohur me pyetësin dhe kanë marrë udhëzimet lidhur me sjelljen e tyre gjatë intervistimit, teknikat e hulumtimit dhe casjen ndaj të intervistuarve.

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë mbi 250 studentë të vitit të dytë të Kolegjit FAMA, nga të katër qendrat ku operon Kolegji FAMA (Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren). Në fakt, hulumtimi është zhvilluar në kuadër të lëndës: Ndërmarrësia dhe Menaxhimi i NVM-ve, dhe intervistimi i një ndërmarrjeje ka qenë pjesë përbërëse e vlerësimit përfundimtarë në kuadër të lëndës. Nga ky hulumtim do të krijohet një bazë e mirëfilltë e të dhënave, e cila do të shërbej për studentët e nivelit bachelor dhe master në hartimin e temave të diplomës dhe punimeve të magjistraturës.

Hulumtimi është zhvilluar në periudhën dhjetor 2013 – mars 2014. Studentët kanë qenë të lirë të zgjedhin vet një ndërmarrje. I vetmi kusht ka qenë që ndërmarrjet të ishin NVM, pra mos të ishte më e madhe së 250 punëtorë. Hulumtimi është shtrirë në 21 komuna, me një përqendrim më të madh në katër njësitë në të cilat operon Kolegji FAMA. Rrjedhimisht, hulumtimi nuk bazohet në mostër të rastësishme, andaj edhe gjeneralizimi i rezultateve nga ky hulumtim duhet të jetë i kujdesshëm.

Pyetësin në përgjithësi ka përmbajtur 22 pyetje të ndara në 6 kapituj kryesorë. Të gjitha pyetjet kanë qenë të natyrës kuantitative, të mbyllura - me disa opsione. Kapitulli i parë përfshinte pyetje lidhur me të dhënat personale të ndërmarrësit, sic janë mosha, gjinia dhe niveli i edukimit. Në kapitullin e dytë, theksohen të dhënat mbi ndërmarrjen,

sektori, numri i themeluesve dhe viti i themelimit. Kapitulli i tretë përmban të dhënat kryesore mbi afarizmin e ndërmarrjeve të anketuara deri sa kapitulli i katërt identifikon barrierat kryesore në të bërit biznes. Në vazhdim kapitulli i pestë hulumton tendencat për rritje dhe zhvillim. Kapitulli i gjashtë dhe i fundit trajton problematiken e personelit dhe trajnimit të punëtorëve në kuadër të NVM-ve të anketuara.

Tabela e mëposhtme paraqet ndërmarrjet e intervistuar sipas komunave.

Dragash	1
Drenas	3
Ferizaj	2
Fushe Kosove	5
Gjakove	3
Gjilan	17
Kacanik	1
Kamenice	2
Kline	4
Lipjan	4
Malisheve	4
Mitrovice	72
Peje	1
Podujeve	8
Prishtine	37
Prizren	40
Rahovec	12
Skenderaj	4
Suhareke	14
Viti	1
Vushtrri	14
Totali	249

3. Pasqyrë e përgjithshme mbi NVM-të në Kosovë

Institucioni qendror që menaxhon regjistrimin e ndërmarrjeve të reja në Kosovë, është Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ABRK), që funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Sipas këtij institucioni deri në fund të vitit 2013 në Kosovë janë regjistruar 128341 ndërmarrje.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014 gjithsej janë regjistruar 2912 ndërmarrje, ndërsa në tremujorin paraprak janë regjistruar 1805 biznese të reja, Kjo tregon një rritje në mes tremujorëve të njëjtit vit për 1107 ndërmarrje, apo 61.3% më shumë ndërmarrje të regjistruara. Një analizë e ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve dëshmon se kategoria e numrit të punësuarve nga 1-4 (të punësuar) përbënë rreth 2817 ndërmarrje apo 96.8% të ndërmarrjeve të reja, kategoria me 5-9 me 67 (2.3%), 10-19 me 16 (0.5%), 20-49 me 10 ndërmarrje (0.3%) si dhe kategoria me 50-249 me 2 ndërmarrje (0.1%),

Lidhur me sektoret më të preferuara vazhdon dominimi i sektorit të tregtisë kryesisht si rezultat i nevojës së investimeve të vogla fillestare: tregtia me 928 ndërmarrje (31.9%), industria përpunuese 311 (10.7%), hotelet dhe restorantet me 293 (10.6%), ndërtimtaria me 279 (9.6%), pasuritë e patundshme dhe dhënia me qira me 271 (9.3%), transporti, depot dhe telekomunikacioni me 260 ndërmarrje (8.9%), aktivitetet tjera shoqërore dhe personale 230 (7.9%), bujqësia, gjuetia dhe pylltaria 215 (7.4%), ndërsa aktivitetet tjera marrin pjesë në shkallë shumë të vogël.

Shtrirja regjionale e ndërmarrjeve të reja poashtu është një tregues i rëndësishëm lidhur me aktivitetin ndërmarrës nëpër regjione të ndryshme të Kosovës. Në këtë kontekst duhet pranuar se regjioni i Prishtinës prin me 700 sosh (shprehur në përqindje 24%), Prizreni me 240 (8.3%), dhe Ferizaj me 243 (8.3%), Gjilani me 155 (5.5%), Peja me 144 (4.9%), Gjakova me 130 (4.5%), Mitrovica me 122 (4.2%), Podujeva me 119 (4.1%), ndërsa komunat tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të reja gjatë këtij tremujori.

4. Hyrjet dhe daljet nga tregu.

Teoritikisht, por bazuar edhe në shumë hulumtime empirike, është dëshmuar se ndërmarrjet e vogal dhe të mesme kanë një shkallë të lartë të dështimit/mbylljes. Në literaturën e shumtë në këtë kontekst thuhet se mbi 50% të ndërmarrjeve mbyllet në dy vitet e para të operimit. Edhe pse nuk është bërë ndonjë studim në Kosovë që hulumton normën e dështimit të NVM-ve në Kosovë, nuk është për tu cuditur nëse norma e mbylljes së bizneseve në dy vitet e para është më shumë se 50%. Kjo kryesisht lidhet me kushtet e vështira për të bërë biznes në Kosovë, ambientin ekstrem për zhvillimin e biznesit dhe rritjen e ndërmarrjeve, si dhe mungesën e përgatitjes së mirëfillt të ndërmarrësve para se të hyjnë në treg.

Sidoqoftë numri i ndërmarrje të regjistruara gjatë vitit 2013 është 9203, që është një numër i njëjtë në krahasim me vitet 2011-2012. Ndërsa, numri i ndërmarrjeve të shuara është 1516. Nga ndërmarrjet e shuara në Kosovë sipas llojit të pronësisë, bizneset individuale dominojnë dukshëm me një numër prej 1424 biznese të shuara, shprehur në përqindje 93.93 %, ndërsa ndërmarrjet e shuara si ortakëri e përgjithshme janë 37 shprehur në përqindje 2.44 %, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar 47, shprehur në përqindje 3.10 % dhe të tjerat nën 1%.

Bazuar në të dhënat e marra nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare ndërmarrjet e regjistruara me pronar meshkuj dominojnë 114173 ndërmarrje ose shprehur në përqindje prej 88.96 % në krahasim me ndërmarrjet me femra pronare janë 14168 ose shprehur në përqindje 11.04%.

Shuarja e ndërmarrjeve sipas gjinisë dominon te ndërmarrjet me pronar meshkuj, nga totali i 1516 ndërmarrjeve të shuara prej tyre 1264 apo 83.38% e ndërmarrjeve të shuara janë ndërmarrje me pronar meshkuj, në krahasim me ndërmarrjet e shuara me pronësi të femrave që është 252 apo 16.62% nga ndërmarrjet e shuara për vitin 2013.

5. Rezultatet e Hulumtimit

Në hulumtim janë përfshirë 249 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, 113 prej tyre përkatësisht 45.4% i përkasin tregtisë, 44 ndërmarrje përkatësisht 17.7% i përkasin prodhimit, kurse 92 ndërmarrje ose në përqindje 36.9% janë në sektorin e shërbimeve. Mbi 90% e udhëheqësve të këtyre ndërmarrjeve janë të gjinisë mashkullore. Për nga niveli i kualifikimit, dominojnë udhëheqësit me fakultet me 51.4% dhe ata me shkollë të mesme me 46.2%, kurse vetëm 2% e tyre janë me shkollë fillore.

Çfarë afarizmi keni pasur gjatë vitit 2013


Në pyetjen çfarë afarizmi keni pasur gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012, 48.4% e të gjitha ndërmarrjeve janë deklaruar se kishin afarizem më të mirë se në vitin paraprak, 31.5% janë deklaruar se nuk kishin ndonjë ndryshim, ndërsa ata që kishin aktivitet më të keq se vitin e kaluar ishin diku rreth 20.2%.

	Numri i NVM-ve	Përqindja
Më të mire se vitin 2012	120	48,4
Nuk ka ndonjë ndryshim	78	31,5
Më keq se në vitin 2012	50	20,2
Total	248	100,0
Total	249	

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

Nëse i shikojmë sipas sektorëve, vërehet një ecuri më e mirë të prodhimit dhe shërbimet në krahasim me tregtinë. Rreth 60% e ndërmarrjeve që i përkasin sektorit të prodhimit kishin afarizem më të mirë në vitin 2013, krahasuar me një vit më parë, te sektori i shërbimeve kjo përqindje ishte diku rreth 56%, kurse tregtia ngelet me mbrapa me vetëm 39%.

Nëse marrim për bazë edhe ndërmarrjet që janë deklaruar se nuk kishin ndonjë ndryshim me vitin paraprak, dhe ato që ishin më keq, rezulton se rreth 80% nga total i ndërmarrjeve të përfshira në këtë hulumtim, ishin më mirë ose pa ndonjë ndryshim me një vit më parë, dhe rreth 20% e tyre ishin më keq sesa periudhen paraprake.



Natyrisht, me dallime në mes të sektorëve, duke qëndruar më mirë prodhimi dhe shërbimet, krahasuar me tregtinë.

Çfarë afarizmi prisni për vitin 2014

Në pyetjen, çfarë afarizmi prisni për vitin 2014, 206 ndërmarrje përkatësisht 83.4% e të deklaruarve në këtë pyetje, presin një afarizem më të mirë se në vitin 2013.

Në raport me këtë pyetje nuk vërehet ndonjë dallim në mes të sektorëve. Mesatarisht mbi 83% e ndërmarrjeve në të gjitha sektorët kanë këtë përgjigje: për ndërmarrjen tonë viti 2014 do të jetë më i mirë se viti 2013.

Tabela 2: Çfarë afarizmi pritni për vitin 2014

	Numri NVM-ve	Përqindja
Më të mirë se vitin 2013	206	83,4
Nuk ka ndonje ndryshim	31	96,0
Më keq se në vitin 2013	10	100,0
Total	247	

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

Gjithashtu, një e dhënë tjetër e rëndësishme që del nga kjo pyetje, është përqindja tepër e vogël e atyre që presin afarizem më të keq se në vitin 2013 (vetëm 4% e rrespondentëve).

A keni bërë investime në vitin 2013

Në pyetjen, a keni bërë investime në vitin 2013, 81.4% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht. Edhe këtu vërehet një shtrirje proporcionale sa i përket sektorëve, me një dallim të vogël në përqindje.

Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme vërehet që shërbimet kanë një tendencë më të madhe për tu zgjeruar, në krahasim me dy sektorët tjerë, e sidomos në raport me tregtinë.

Tabela 3. A keni bërë investime në vitin 2013


Sektori	A keni bërë investime në vitin 2013		Total
	Po	Jo	
Tregti	77.7%	22.3%	100.0%
	36	8	44
Prodhim	81.8%	18.2%	100.0%
	78	13	91
Shërbim	85.7%	14.3%	100.0%
	46	247	
Total	81.4%	18.6%	100.0%

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

A planifikoni të bëni investime në të ardhmen

Në pyetjen, a planifikoni të bëni investime në të ardhmen, 86% e ndërmarrjeve janë deklaruar se planifikojnë zgjerimin e biznesit të tyre me investime shtesë. Nuk vërehet ndonjë dallim i theksuar në mes të sektorëve sa i përket pritjeve për investime në të

ardhmen, megjithatë vërehet një epërsi e lehtë e sektorit të prodhimit, krahasuar me dy sektorët tjerë.



Mbi 90% e ndermarrjeve që i përkasin sektorit të prodhimit presin rritje të investimeve në vitin e ardhshëm, ndërsa te sektoret shërbime dhe tregti, kjo përqindje sillet diku rreth 84.5%.

A keni pasur punëtor të rinjë në vitin 2013?

Ecuria pozitive e biznesit është e lidhur ngusht me rritjen e numrit të të punësuarve, megjithëse jo domosdoshmërisht me përqindje të njëjët. Edhe në këtë hulumtim vërehet ky relacion. Rreth 60% e ndermarrjeve të anketuara kishin punësuar punëtor të rinjë gjatë vitit 2013. Sektorët prodhim dhe shërbime, sektorë këta të cilët kishin shënuar rritje më të madhe të aktivitetit të tyre ekonomik në krahasim me tregtinë, kanë pasur po ashtu një ndikim më të theksuar edhe në punësimin e punëtorëve të rinj.

Tabela 4. A keni punësuar punëtorë të rinj në vitin 2013				Total
		Po	Jo	
Sektori	Tregti	56	57	113
		49.6%	50.4%	100.0%
Prodhim		30	14	44
		68.2%	31.8%	100.0%
Shërbim		65	27	92
		70.7%	29.3%	100.0%
Total		151	98	249

60.6%


39.4%

100.0%

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

A planifikoni të punësoni punëtor të rinjë?

Në pyetjen, a planifikoni të punësoni punëtor të rinjë, rreth 2/3 e ndermarrjeve nga të gjithë sektorët, kanë në planet e tyre rritjen e numrit të të punësuarve në vitin e ardhshëm (2014).



Edhe këtu vërehet një dominim i lehtë i sektorit të shërbimeve në gjenerimin e vendeve të reja të punës, por nuk vërehet ndonjë ndryshim shumë i madh edhe në sektorët tjerë.

Rritja e numrit të të punësuarve nga themelimi e deri me sot

Vlen të përmendet fakti se rreth 60% e këtyre ndërmarrësve që kanë punësuar punëtor të rinjë, kishin nivel të kualifikimit Universitar, 41% ishin me shkollë të mesme dhe vetëm 0.6% me shkollë fillore. Pra, edhe nga ky hulumtim del ne pah lidhja positive në mes shkallës së kualifikimit dhe rritjes së biznesit, sa më i lartë niveli i kualifikimit të udhëheqësve të ndërmarrjeve, aq më të mëdha mundësitë për t'u zgjeruar si biznes dhe rrjedhimisht aq më shumë vende të lira pune.

Nga 249 ndërmarrjet e përfshira në këtë hulumtim, 202 prej tyre kanë shënuar rritje të numrit të të punësuarve që nga koha e themelimit të tyre, 30 prej tyre nuk kishin ndonjë

ndryshim të numrit të të punësuarve, kurse vtem 16 sosh kishin shenuar ulje të numrit të punësuarve

Nëse analizojmë ndermarrjet që paten rritje te numrit të të punëuarve gjatë jetëgjatësisë tyre (202 ndermarrje), shohim se 88 nga to ose në përqindje 43.6% i përkasin sektorit të tregtisë, 39 ndermarrje perkatësisht 19.3% i takojnë sektorit të prodhimit, dhe pjesa e mbetur prej 75 ndermarrjeve ose në perqindje 37.1% i përkasin sektorit të shërbimeve.

Tabela 5: Rritja e Ndermarrjes				Total
Sektor	Ndermarrja nuk ka rritur numrin e punetoreve	Ndermarrja ka Shenuar Rritje te Numrit te Punetoreve	Ndermarrja ka shenuar ulje te numrit te punetoreve	
Tregti	17 56.7%	88 43.6%	7 43.8%	112 45.2%
Prodhim	2 6.7%	39 19.3%	3 18.8%	44 17.7%
Sherbim	11 36.7%	75 37.1%	6 37.5%	92 37.1%
Total	30 100.0%	202 100.0%	16 100.0%	248 100.0%

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

Nga këto 202 ndermarrje që kishin shenuar rritje të numrit të të punësuarve që nga themelimi i tyre, 53% e tyre kishin aktivitet me të mirë ekonomik në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, 29.2% e tyre nuk kanë shenuar ndonjë ndryshim në aktivitetin e tyre ekonomik, kurse një përqindje më e vogël prej rreth 17% kanë deklaruar aktivitet më të dobët në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012.

Në bazë të të dhënave të mësipërme mund të konstatojmë, se vërtetohet lidhja e drejt ne mes të rritjes së ndermarrjes dhe numrit të të punësuarve. Megjithatë, me kalimin e

kohes, ka ndërmarrje që edhe pse dikur kishin rritje të numrit të të punësuarve, aktiviteti i tyre jo domosdoshmerisht vazhdon të jetë në rritje.

Sa i përket planifikimeve për vitin 2014, shumica absolute e ndermarrjeve duke përfshirë këtu ndermarrjet e të gjitha kategorive, edhe ato që kishin rritje të numrit të punësuarve nga koha e themelimit e deri me sot, edhe ato që nuk kishin ndonjë ndryshim, por edhe ato që paten ulje të numrit të të punësuarve, presin që viti 2014 të jetë më i mirë se viti 2013.

Vlen të permendet një e dhënë e rëndësishme, se asnjë nga ndermarrjet që i përket grupit të atyre që kishin shenuar ulje të numrit të të punësuarve që nga koha e themelimit, nuk pret afarizem më të keq në vitin e ardhshëm krahasuar me një vit më parë

A keni pasur plan të biznesit para se të hapni biznesin tuaj?

Ekziston një bindje e drejt te shumica e ndërmarrjeve në Kosovë në lidhje me rëndësinë që ka plani i biznesit për një ndërmarrje dhe sidomos për hapjen e një biznesi të ri. Nga ndërmarrjet e përfshira në hulumtim, 57.8% të tyre kanë deklaruar se kanë pasur plan të biznesit para se të hapin biznesin e tyre, ndërsa 41.4% të tyre kanë deklaruar se nuk kanë pasur plan të biznesit para se të hapin atë.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	JO	103	41,4	41.7	41.7
	PO	144	57.8	58.3	100.0
Total		249	100,0		

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

Megjithatë, mund të konstatohet se në bazë të rezultateve të këtij hulumtimi, ekzistojnë një numer relativisht i madh i ndërmarrjeve që kanë filluar biznesin pa plan të biznesit (41.4%) që jep të kuptohet që shumë ndërmarrje në Kosovë fillojnë aktivitetin e tyre

afarist pa ndonjë planifikim ose analizë në mënyrë të shkruar. Kjo mund të jetë për shkak të mungesës së përgatitjes së duhur të përgatitjes profesionale të ndërmarrësve të rinjë ose mungesës së besimit në suksesin e implementimit të saj, për shkak të dinamikës dhe paqendrueshmërisë së tregut.

A keni tani plan të biznesit

Në pyetjen se a kanë tani plan të biznesit, vërehet dukshëm një avancim i bindjeve të ndërmarrjet e anketuara në Kosovë, në lidhje me rëndësinë e të pasurit plan të biznesit dhe efektet e saj për një afarizëm të sukseshëm të tyre. Është 73.5% numri i ndërmarrjeve të anketuara në këtë hulumtim që kanë deklaruar se kanë të shkruar plan biznesi, ndërsa 24.9% të tyre deklaruan se nuk kanë edhe më tutje plan të biznesit për ndërmarrjet e tyre edhe përkundër faktit që ato mund të kenë pengesa në zhvillimin e tyre, që lenë të kuptohet se ky numër i ndërmarrësve në Kosovë, ekzistimin ose jo të një plani të biznesit nuk e konsiderojnë si faktorë të rëndësishëm në suksesin ose jo të afarizmit të ndërmarrjes.

Tabela 7: A keni tani plan te biznesit

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	JO	62	24.9	25.3	25.3
	PO	183	73.5	74.7	100.0
	Total	245	98.4	100,0	
Total		249	100,0		

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

A keni pasur plan të biznesit para se të hapni biznesin tuaj

Në tabelat e mëposhtme janë të dhënat e hulumtimit të prezentuara në tabelat e kryqëzuara me dy nga faktorët e mundshëm që mund të ndikojnë në rritjen e ndërmarrjes – posedimi i një plani të biznesit dhe numri i punëtorëve në ndërmarrje në një periudhë të caktuar.

Hulumtimi nxjerrë të dhëna të cuditshme ku p.sh. nga ndërmarrjet që kanë deklaruar se nuk kanë pasur plan biznesi para se ta formojnë firmën vetëm 18.8% të tyre kanë deklaruar se në periudhen në vazhdim të afarizmit të tyre kanë pasur rënje të numrit të punëtorëve, ndërsa 81.2% të ndërmarrje që kanë deklaruar se biznesin e kanë filluar duke pasur një plan biznesi kanë deklaruar se kanë shenuar ulje të numrit të punëtorëve. Nëse rritja e numrit të punëtorëve në një ndërmarrje konsiderohet si parametër i besueshëm për të vlerësuar performancën e një ndërmarrje (41.6% të ndërmarrjeve që nuk kanë pasur plan biznesi kanë deklaruar se kanë pasur rritje të numrit të punëtorëve) dhe nëse kur ndërmarrje nuk ka rritur numrin e punëtorëve nuk konsiderohet si trend negativ i zhvillimit të saj (53.6% të ndërmarrjeve që nuk kanë pasur plan biznesi kanë deklaruar se nuk kanë pasë rritje të numrit të punëtorëve), atëherë mund të konsiderohet se numri i ndërmarrjeve që nuk kanë filluar biznesin me një biznesplan paraprak dhe që kanë pasur afarizem të suksesshëm është dukshëm më i madh se sa i atyre që kanë poseduar një plan të tillë (81.2% të ndërmarrjeve që kanë startuar me një plan biznesi kanë deklaruar se kanë shenuar ulje të numrit të punëtorëve)

A keni pasur plan të biznesit para se të hapni biznesin tuaj

Tabela 8.	Rritja e Ndermarrjes			Total
A keni pasur plan biznesi para se ta hapni ndërmarrjen tuaj	Ndermarrja nuk ka rritur numrin e punetoreve	Ndermarrja ka shenuar rritje te numrit te punetoreve	Ndermarrja ka shenuar ulje te numrit te punetoreve	
JO	15	84	3	102
	53.6%	41.6%	18.8%	41.5%
PO	13	118	13	144
	46.4%	58.4%	81.2%	58.5%
Total	28	202	16	246
	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

Situatë e ngashme paraqitet edhe në kryqëzimin e tabelave me pyetjet për ndërmarrjet në lidhje me ekzistimin aktual të planit të biznesit në një ndërmarrje dhe numrit të punëtorëve të saj në periudha të ndryshme kohore. 75% të bizneseve që kanë deklaruar se aktualisht kanë plan biznesi kanë shënuar ulje të numrit të punëtorëve , ndërsa 25% të atyre që nuk posedojnë plan biznesi kanë shënuar ulje të numrit të punëtorëve

A keni tani plan të biznesit

Tabela 9.	Rritja e Ndermarrjes			Total
A keni pasur plan biznesi para se ta hapni ndërmarrjen tuaj	Ndermarrja nuk ka rritur numrin e punetoreve	Ndermarrja ka shënuar rritje te numrit te punetoreve	Ndermarrja ka shënuar ulje te numrit te punetoreve	
JO	11 39.3%	46 23.0%	4 25.0%	61 25.0%
PO	17 60.7%	154 77.0%	12 75.0%	183 75.0%
Total	28 100.0%	200 100.0%	16 100.0%	244 100.0%

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

A keni qenë të punësuar para se ta hapni firmën tuaj

Nga tabela e mëposhtme vërehen qartë të dhëna mjaft indikative për rrethanat në të cilat themelohen bizneset e reja në Kosovë. Nga ky hulumtim del se 36.1% e ndërmarrësve themelimin e firmës së tyre e kanë pasur edhe vendin e tyre të parë të punës. Kjo tregon qartë në mungesën totale të tyre të përvojës në sferën e biznesit. Kjo mund të spjegoj deri në një masë edhe arsyen e mungesës së planit të biznesit të disa nga ndërmarrjet e reja, analizë të cilën e bëmë më lartë.

Tabela 10: A keni qenë të punësuar para se ta hapni firmën tuaj

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	JO	90	36.1	36.7	36.7
	PO	155	62.2	63.3	100.0
	Total	245	98.4	100,0	
Total		249	100,0		

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

Megjithatë, nga ky hulumtim del se ekziston një masë e madhe e ndërmarrësve që para se të krijojnë një biznes kanë një përvojë afariste ose një përvojë pune ne biznes. 62.2% të tyre janë deklarur se kanë qenë të punësuar para se të themelojnë biznesin e tyre.

Cila ka qenë arsyeja e kryesore e hapjes së firmës tuaj

Në pyetjen se cila ka qenë arsyeja kryesore për hapjen e biznesit, nga ky hulumtim rezulton se përgjigjja më e shpeshtë del ajo që është vërejtur mundësi biznesi profitabil në një sektor të caktuar. 41.4% të tyre janë deklaruar se kjo ka qenë arsye e një vendimi të tillë. Kjo lenë për të kuptuar se ky grup i ndërmarrësve, kanë bërë një kërkim dhe analizë të tregut para se të marrin vendimin për hapjen e biznesit të tyre. Të dhëna mjaft interesante dalin edhe nga përgjigjet tjera në këtë pyetje. P.sh. 10.8% e të deklaruarve thonë se kanë hapur bizneset vetëm për të siguruar një punësim vetvetës, pra sa për të filluar dicka ose për afërisht me të njëjtën përqindje (10%) janë deklaruar se motive kryesor i tyre për hapje të biznesit ka qenë dëshira për të punuar i pavarur nga shefi. Për të dy këto kategori të krijuesëve të bizneseve mund të thuhet se nuk i takojnë grupeve normale ndërmarrësve të cilët kanë hapur firmen pas një analize të tregut (41.4% të deklaruar sit ë tillë) ose kanë një gjë të tillë e kanë pasur si synim (27.7% të deklaruar si të tillë) ose edhe e kanë trashëguar një biznes (8% të deklaruar sit ë tillë)

Tabela 11: Cila ka qenë arsyeja kryesore për hapjen e firmës tuaj

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Të punoj i pavarur nga shefi im	25	10.0	10.2	10.2
	Kam dashur të realizoj ëndrrën për të pasur ndërmarrjen time	69	27.7	28.0	38.2
	Kam qenë i papunësuar dhe është dashur të bëjë dicka	27	10.8	11.0	49.2
	E kam vërejtur mundësinë e biznesit dhe kam vendosur ta shfrytëzoj atë e ta hap ndërmarrjen	103	41.4	41.9	91.1
	E kam trashëguar nga familja	20	8.0	8.1	99.2
	Total	246	98.8	100,0	
Missing	System	2	1.2		
	Total	248	100,0		

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

Në fund të fund mund të konstatojmë se ndërmarrjet në Kosovë janë shumë të reja dhe nuk kanë ndonjë përvojë të madhe të trashëguar nga koha e gjatë e ekzistencës së tyre. Nga ky hulumtim del se vetëm 8% e këtyre ndërmarrjeve janë të trashëguara nga familja që e që vetëm këto mund të japin mundësinë se ekzistojnë nga një periudhë e gjatë kohore.

Barrierat në Biznes

Përkundër disa përmirësimeve të ambientit të të bërit biznes sidomos nga aspekti legjislativ që është dëshmuar edhe me rangimin e Kosovës në Indexin e Bankës Botrore të të Bërit Biznes, ambienti për biznes në Kosovë, mbetet i karakterizuar, nga korrupsioni dhe konkurrenca jo lojale. Këto barrierat mbesin të njëjta, dhe pa ndonjë


dallim substancial, gjatë pesë vjecarit të fundit. Menjëherë pas lufte bizneset kosovare ankoheshin për mungesën e rrymës dhe ceshtjet tjera infrastrukturore. Me adresimin e këtyre problemeve në një masë të mjaftueshme, bizneset më shumë i orientojnë ankesat e tyre kah faktorët që lidhen me aspektin institucional dhe ligjor.

Në fakt, është detyrë e institucioneve qoftë atyre kombëtare apo lokale të ofrojnë kushte të barabarta për të gjithë akterët në treg. Megjithatë, kjo nuk është duke ndodhur, për arsye se ende bizneset vazhdojnë të ankohen lidhur me konkurrencën jo lojale dhe korrupsionin si disa nga barrierat më të mëdha të të bërit biznes.

Tabela 11: Barrierat ne Biznes	Mesatarja
Taksat e Larta	3,35
Konkurrenca e ashpër/fortë	3,42
Konkurrenca jolojale	3,59
Korrupsioni	3,08
Çasja në kredi	2,72
Aftësitë tuaja menaxheriale	1,39
Niveli i aftësive të të punësuarëve	1,91
Mungesa e kërkesës	2,52
Vonimi i pagesave	2,91

Burimi: Hulumtimi me 250 NVM, Kolegji FAMA, 2013

Vonimi i pagesave është tjetër brengë a bizneseve kosovare. Kjo lidhet ngusht me sundimin e ligjit pasi që mos respektimi i kontratave dhe vonesa në pagesa është duke shkaktuar cregullim në rrjedhën e parave të ndërmarrjes, dhe ka efekt zinxhiror tek bizneset tjera në kuadër të krijimit të zinxhirit të vlerës.



Përkundër faktit që resurset e brendshme të kompanive nuk konsiderohen si pengesa të mëdha nga ndërmarrësit dhe ndërmarrësitë nuk janë vetkritik, këto resurse duhet të identifikohen dhe trajtohen seriozisht nga vetë ata me qëllim të krijimit të kapaciteteve njerëzore më të suksesshme dhe konkurrencte me vendet e rajonin dhe më gjerë.

6. Konkluzat dhe Rekomandimet

Nga hulumtimi me rreth 250 dhe rezultatet e prezentuara me lart, në mënyrë të përmbledhur do të paraqiten konkluzat dhe rekomandimet në vijim.

Konkluzionet

- Sektori i NVM-ve përkundër faktit që krijon shumicën e vendeve të punës, vazhdon të jetë i brishtë dhe të mos prodhoj vende të mjaftueshme të punës.
- Ambienti i të bërit biznes përkundër përmirësimeve të vitit të fundit, vazhdon të karakterizohet nga konkurrenca jolojale dhe korrupsioni.
- Mbi 90% të ndërmarrësve janë të gjinisë mashkullore, duke prezentuar një përfshirje shumë të vogël të femrave në ndërmarrësi.
- Mbi 50% të bizneseve kanë patur afarizëm më të keq ose të njëjtë me vitin e kaluar, derisa mbi 80 % të ndërmarrjeve presin afarizëm më të mirë në vitin vijues.
- Mbi 80% e ndërmarrjeve të anketuara kanë pasur investime dhe ky trend nuk pritët të zvoglohet as viteve në vijim.
- Një numër i konsiderueshëm i bizneseve kanë plane të biznesit

Rekomandimet

- Fokusimi në Sektorin e NVM-ve si gjenerues kryesor i vendeve të reja të punës.
- Kompletimi i infrastrukturës ligjore të nevojshme për adresimin e konkurrencës jolojale dhe korrupsionit
- Krijimi i politikave inkurajuese për rritjen e pjesëmarrjes së femrave ndërmarrëse në ekonomi duke lehtësuar krijimin e ndërmarrjeve të reja dhe subvencionimin e aktiviteteve fillestare të ndërmarrësive të reja.
- Krijimi i politikave lehtësuese për qasjen në kredi të NVM-ve me potencial të rritjes së shpejtë.
- Krijimi i politikave stimuluese për formalizimin e bizneseve duke përfshirë masat lehtësuese dhe iniciativat e nevojshme
- Zhvillimi i tregut të konsulencës për biznese
- Investimi nga ana e NVM-ve më shumë në resurset e brendshme si faktor potencial i rritjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve